

REPUBLICA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË
DHOMA CIVILE

Nr.Regj.Them. 686
Data e Regjistrimit 13.04.2022

Nr. Vendimit 5934/4
Data 23.09.2022

VENDIM
Në emër të Republikës

(PËR DEPOZITIM VENDIMI NË REGJISTRIN E OJF-ve)

GJYQTARE: Enkela Bajo Vlora

sot më datë 23.09.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, kërkesën që i përket:

KËRKUES: Shoqata Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), me adresë rruga Muhamet Gjollësja, sheshi Mustafa Atatürk, Tirane

OBJEKTI: Depozitimin dhe rregjistrimin e vendimit date 02.04.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme (APJ) të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e RSh; ligji 8788/date 07.05.2001 dhe ligji 8789/date 07.05.2001; ligji 79/2017, i ndryshuar.

Gjykata, pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi kërkesën dhe aktet bashkëlidhur saj,

VËREN

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është organizatë shoqërore joqeveritare, jo fitimprurëse, e rregjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim Nr. 5934 / Dt. 22/ 06 /2018 dhe që rregullohet sipas akteve të saj themeluese-akt themelimi dhe statut; në këto gjeje të parashikuara emertimin, organizimin e saj, etj.

Nga ana e këtij subjekti janë depozituar në vijim në gjykatë akte mbi ndryshimet e bera (përkatesisht me vendimet gjyqësore nr.5934/1, 5934/2 dhe 5934/3).

Ne daten 12 Prill 2022, Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar, i cili është drejtuar me kerkese Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per rregjistrimin e vendimeve te marra nga Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme e Dates 02.04.2022, Asambleja e kjo e kerkuar nga 1/3 e anetareve te saj, bazuar ne nenin 18 te Statutit te KOKSH, me Referendumi si me poshte:

1-Mocion mosbesimi pe mbajtesin e thesarit te Komitetit Egzekutiv te KOKSH,z.Genc Boga(dhe aresyet)

2-Mocion mosbesimi per anetaren e Komitetit Egzekutiv te KOKSH , zj.Tatjana Marash(dhe aresyet).

Sipas Proces-verbalit te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme te dates 02/Prill/2022, si edhe Memorandumit te Dates 05/Prill/2022 te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme te KOKSH,ne teresine e tyre anetaret e KOKSH me te drejte vote perfaqesohen nga 63 individe dhe ne APJ ishin present 58 individe ,fakt mbi te cilin KEV vleresoi se kuorumi prej 2/3 te 63 individeve eshte arritur.

Ne mbledhjen e asamblese te mbajtur me kuorumin e nevojshem prej 2/3,eshte vendosur:

1-Aprovimi i mocionit te mosbesimi nga Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme dhe shkarkimin e menjehershem te Z. Genc Boga nga detyra si anetar I KE si edhe nga Mbajtes i Thesarit te KOKSH.

2-Aprovimi i mocionit te mosbesimi nga Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme dhe shkarkimin e menjehershem te Znj. Tatiana Marash nga detyra si anetare e KE te KOKSH.

Nga pala kerkuese se bashku me kerkesen jane paraqitur dhe teresia e akteve shoqeruese (plotesuar ne vijim nga pala kerkuese mbi bazen e detyrave te lena nga gjykata),si:kerkesa per thirrje te asamblese se jashtezakonshme,procesverbali I mbledhjes, memorandum,aktet e mbajtura nga KVE,procesverbale mes Sekretariatit te KOKSH dhe KVE,listat e pjesemarrjesve me te drejte dhe pa te drejte vote,email per njoftim zyrtar te mbledhjes se asamblese,etj.

Nisur nga teresia e dokumentacionit te paraqitur ne gjykate dhe bazuar ne rregullimet e statutit te shoqates mbi asamblene, kompetencat e saj,menyren e thirrjes se asamblese,kuorumet perkatese, vlefshmerine e vendimmarrjes,etj(me konkretisht nenet 16,18 e vijues),mbi komitetin egzekutiv,etj gjykata cmon qe kerkesa dhe aktet jane te bazuara ne prova ,ne statut dhe ne ligj dhe duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te ligjit 7850 date 29.07.1994 nenet 39-53 te ligjit 8781 Date 03.05.2001, ligjit 8788 dt 07.05.2001 dhe Ligji NR.8789 DT.07/05/2001.

VENDOSI

1- Pranimin e kërkesës

Depozitim të Proces-verbalit dhe Memorandumit të datës 05/04/2022 të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), në të cilin është vendosur:

1-Aprovimi i mocionit të mosbesimi nga Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme dhe shkarkimin e menjehershëm të Z. Genc Boga nga detyra si anetar I KE si edhe nga Mbajtës i Thesarit të KOKSH.

2-Aprovimi i mocionit të mosbesimi nga Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme dhe shkarkimin e menjehershëm të Znj. Tatiana Marash nga detyra si anetare e KE të KOKSH.

2-Depozitim të këtij dokumentacioni dhe akteve shoqeruese pranë Zyres së Rregjistrimit të Organizatave Jofitimpruese të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3-Urdhërohet Zyra e Regjistrimit të OJF-ve të pasqyrojë në regjistër ndryshimet përkatëse.

-Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

-U shpall sot më datë 23.09.2022 në Tiranë.

GJYQTARE

